

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK). Vizioni i kësaj strategjie është krijimi i institucioneve transparente, me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe që garantojnë shërbim cilësor dhe të pa-korruptueshëm. Ky vizion është adoptuar në tre qasje, parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese, ndaj korrupsionit.

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të qasjes ndërgjegjësuese, Ministria e Drejtësisë harton çdo vit Strategjinë e Komunikimit dhe Vizibilitetit në fushën antikorrupsion. Nëpërmjet saj, Ministria synon të arrijë audiencë të ndryshme, brenda dhe jashtë institucioneve shtetërore dhe të ndërtojë një marrëdhënie të re me qytetarët, bazuar në besimin e ndërsjellë për parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit. Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Gusht, 2021

Hartimi dhe konsultimi i Draft-Raportit Gjashtëmujor të Monitorimit të Planit të Veprimit, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit

06.08.2021. Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, përfundoi procesin e monitorimit dhe hartoi draft-raportin gjashtëmujor të monitorimit të Planit të Veprimit, 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën Janar-Qershor 2021. Draft-raporti i monitorimit paraqet në mënyrë analitike dhe sasore progresin e bërë nga të gjitha institucionet raportuese për zbatimin e masave/aktiviteteve të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, nivelin e realizimit të indikatorëve, nivelin e realizimit të objektivëve strategjikë si edhe ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin e kaluar të monitorimit. Ky është raporti i dytë i monitorimit të Planit të Veprimit në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për vitin 2021. Draft-Raporti gjashtëmujor është duke iu nënshtruar konsultimit institucional me të gjitha institucionet raportuese si edhe konsultimit të gjerë me publikun dhe OSHC-të. Draft-Raporti gjashtëmujor do të finalizohet në muajin Shtator 2021 dhe do të diskutohet dhe miratohet në mbledhjen e Komitetit Koordinator për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit.

Draft-Raporti Gjashtëmujor është i aksesueshëm në këtë link: <http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/08/Draft-Raporti-i-monitorimit-SNKK-Janar-Qershor-2021-AL.pdf>



Hartimi dhe konsultimi i Draft-Raportit të Vetëvlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2020-2022, të Partneritet për Qeverisje të Hapur


04.08.2021. Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, përfundoi hartimin e Draft-Raportit të Vetëvlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2020-2022, të Partneritet për Qeverisje të Hapur. Ky raport vetëvlerësimi është referues për periudhën vjetore 2020 dhe periudhën Janar-Qershor 2021. Raporti i Vetëvlerësimit është hartuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit dhe të analizës së Mekanizmit të Raportimit të Pavarur (eng. IRM) të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (eng. OGP). Raporti i Vetëvlerësimit përmban një analizë përmbledhëse të arritjeve dhe realizueshmërisë së Planit Kombëtar të Veprimit, për komponentin 1: antikorrupsioni – planet e integritetit, në relevancë me vlerat e qeverisjes së hapur që janë: transparencja dhe qasja në informacion, përgjegjësia publike, pjesëmarrja publike dhe qytetare si dhe teknologji e inovacion. Raporti i Vetëvlerësimit është konsultuar me OSHC-të bashkë-bërëse të Planit Kombëtar të Veprimit 2020-2022 dhe do të diskutohet dhe miratohet në mbledhjen Grupit Tematik të Politikë-bërjes në Shtator 2021.

Draft-Raporti i Vetëvlerësimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2020-2022, të Partneritet për Qeverisje të Hapur është i aksesueshëm në këtë link: <https://ogp.gov.al/artikull/raporte-monitorimi-lufta-kunder-korrupsionit>

Faza e dytë e konsultimit publik të Draft-Instrumentit Metodologjik të Monitorimit të Planit të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore

11.08.2021. Ministria e Drejtësisë, ka hartuar Draft-Instrumentin Metodologjik të Monitorimit të Planit të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, në përputhje me parashikimin e bërë në Planin Kombëtar të Veprimit 2020-2022, të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (eng. OGP), pika e referimit nr.9, masën prioritarë nr.2, angazhimin nr.1 të komponentit tematik antikorrupsion. Draft-dokumenti iu nënshtrua fazës së parë të konsultimit publik në përputhje me parimin e bashkë-bërjes së dokumenteve të politikave me organizata aktive të Shoqërisë Civile në vend, komentet dhe sugjerimet e të cilave u reflektuan plotësisht në dokument. Dokumenti u konsultua edhe me ekspertë të fushës së integritetit pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian. Instrumenti Metodologjik i Monitorimit të Planit të Integritetit është i pari që hartohet dhe vjen menjëherë pas zhvillimit të instrumentit plan integriteti në qeverisjen qendrore. Instrumenti do të lehtësojë monitorimin e planeve të integritetit dhe do të ofrojë raporte informative mbi zbatimin e tyre dhe mundësinë për përmirësim dhe rishikim.

Draft-dokumenti është i aksesueshëm në këtë link: <http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/08/Draft-Metodologjia-e-Monitorimit-te-Planit-te-Integritetit-AL.pdf>



Denonco çdo rast korrupsioni!

02.08.2021. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit i është drejtuar të gjithë qytetarëve shqiptarë, individë dhe biznese që operojnë në vend, të jenë aktive në luftën kundër korrupsionit. Pas konsolidimit të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, në 17 agjenci, drejtori dhe institucione, që ofrojnë shërbime publike në nivel qendror dhe në tre prej tyre dhe në nivel vendor, ka vendosur në dispozicion të qytetarëve një kanal denoncimi, që është komunikimi i drejtpërdrejtë elektronik me koordinatorët antikorrupsion. Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion operon në: Agjencinë Shtetërore të Kadastrës; ADISA-n; Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit; Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile; Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave; Drejtorinë e Përgjithshme Detare; Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural; Autoritetin Kombëtar të Ushqimit; Agjencinë Kombëtare të Bregdetit; Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura; Agjencinë Kombëtare të Mjedisit; Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar; Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë; dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për veprime korruptive në këto institucione, Ministria e Drejtësisë ka vënë në dispozicion një mundësi të shpejtë dhe të sigurt denoncimi për rastet e korrupsionit, në adresën: koordinatori.ak@drejtesia.gov.al

Fushata e ndërgjegjësimi publik mbi mekanizmat antikorrupsion

03.08.2021. Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit është në proces finalizimi me sukses të një fushate ndërgjegjësimi me qëllim rritjen e informimit qytetar nëpërmjet njohjes së mekanizmave antikorrupsion nga qytetarët dhe publiku i gjerë. 17 video me qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve për të denoncuar korrupsionin pranë Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, video informuese për rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, broshura dhe akte për të advokuar luftën kundër korrupsionit kanë filluar të shfaqen dhe do të vijojnë të publikohen. Qytetarët, biznesi, grupe të ndryshme interesi do të informohen mbi këto mekanizma dhe kërkohen të jenë bashkëpunëtorë në luftën kundër korrupsionit, me moton “Së bashku kundër korrupsionit!” Kjo nismë është në përputhje me Qasjen Ndërgjegjësuese të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe është mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë.

Aksesimi i videove dhe informimi për përdorimin e mekanizmave antikorrupsion do të behët nëpërmjet faqes zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë: www.drejtesia.gov.al dhe nëpërmjet rrjeteve sociale në përdorim, si: <https://www.facebook.com/drejtesia.gov.al> dhe <https://www.facebook.com/EtildaGjonaj>.

